



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë 08.06.2012

**VENDIM  
Nr.226, datë 08.06.2012**

**“Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP  
AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të  
Komisionit të Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita MILO(LATI)	Kryetar
Rezana KONOMI	Nenkryetar
Servete GRUDA	Anëtar
Koço BROKA	Anëtar
Iva ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2012 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palave të treta (MTPL)”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, gërma d, dhe neni 46.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012, të Komisionit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 222, datë 11.04.2012 ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj paleve të treta (MTPL).

Lidhur me këtë vendim ka paraqitur kërkesë për revokimin e tij ndërmarrja “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA, me anë të shkresës së saj nr. 2556 prot. datë 24.05.2012.

Kërkesa e ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 nuk përmbush asnje nga kërkesat e parashikuara nga neni 46 i Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pra është e pabazuar në ligj dhe në prova.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d, nenin 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA për revokimin e vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palave të treta (MTPL)”;
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 222, datë 11.04.2012 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palave të treta (MTPL)”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**  
(                    )  
**Anëtar**

**Koço Broka**  
(                    )  
**Anëtar**

**Rezana Konomi**  
(                    )  
**Nenkryetar**

**Iva Zajmi**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**